




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

00Nr.65/2024

Data: 30.04.2024

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 40 paragrafi 40.2 pika c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 30.04.2024, shqyrtoi dhe miratoi propozimet e Kryetarit të Komunës për bartjen e tejkallimit të të THV 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024, në vlerë prej :**349,754.92 €** dhe mori këtë:

V E N D I M I

TEJKALIMI I PLANIT TË TË HYRAVE PËR VITIN 2023 DHE TË BARTEN PËR SHPENZIM NË VITIN FISKAL 2024, NË VLERË PREJ: 349,754.92 €.

Kuvendi i Komunës së Istogut në mbledhjen e mbajtur me 30.04.2024, miratoi propozimin e Kryetarit të Komunës për bartjen e tejkallimit të të THV 2023, për shpenzim në vitin fiskal 2024, në vlerë prej :**349,754.92 €**, si në vijim:

Shuma totale e të hyrave vetanake të tejkalluar në periudhën Janar – Dhjetor 2023 duke përfshirë të gjitha të hyrat është: **349,754.92 €**, shuma e planifikuar për vitin 2023 është **1,244,588.00 €**, ku shihet se kemi tejkallim të inkasimit të të hyrave vetanake për vitin 2023 në vlerë prej: **349,754.92 €**, në këtë shumë janë të përfshira edhe gjrobat e trafikut.

I. Total shuma prej **349,754.92 €**, të bartet si në vijim:

Nga nën-programet buxhetore nga burimi i financimit 21 shuma prej 349,754.92 €,

Kategoria ekonomike Shpenzime Kapitale: 349,754.92 €.

1. Në kuadër të programit Buxhet dhe Financa me kod 175, nën-programi Buxheti – Istog me kod 17517, të bartet shuma prej 62,122.52 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale me kod 175, nën-programi Buxheti – Istog me kod 17517, të barten në këtë projekt:

1. "Projekti me participim te Komunitetit ,ministrive te linjës,Donatoret e jashtëm ", kodi (50240) ", në shumë prej: 62,122.52 €.
2. Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180 nën-programi Infrastruktura Rrugore – Istog me kod 18017, të bartet shuma prej 10,724.80 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180, nën-programi Infrastruktura Rrugore – Istog me kod 18017, të barten në këto projekte:
 1. "Ndërtimi i kanalizimit në Rakosh Lagja Jahaj", kodi (53398) në shumë prej: 4,857.80 €;
 2. "Ndërtimi i ndriçimit Publik në Zallq-Zabllaq", kodi (53408) në shumë prej : 1,867.00€;
 - 3."Ndërtimi dhe rregullimi i varrezave të reja në Vrellë", kodi (51737) në shumën prej : 4,000.00 €.
3. Në kuadër të programit Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017, të bartet shuma prej 9,377.99 €, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, në programin Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017, të barten në këtë projekt:
 1. " Ndërtimi i kanalit të ujitjes Lagja Demaj në Vrellë" kodi (53250) në shumën prej: 9,377.99 €.
4. Në kuadër të programit Zyra e Komiteteve me kod, 195 nën-programi Zyra komunale për komitete dhe kthim – Istog me kod 19585, të bartet shuma prej 94,217.50 €, në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Zyra e Komiteteve me kod, 195, nën-programi Zyra komunale për komitete dhe kthim – Istog me kod 1958, të barten në këtë projekt:
 - 1." Ndërtimi i rrugës "Sarajeva dhe Isuf Visoqi" në Dobrushë", kodi (54850) në shumë prej 94,217.50 €.
5. Në kuadër të programit Zhvillim Ekonomik me kod 470, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik- Istog me kod 48017, të bartet shuma prej 106,344.00 €, në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, Zhvillim Ekonomik me kod 470, nën-programi nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik- Istog me kod 48017, të barten në këto projekte:

1. "Ndërtimi i rrugës Muzhevinë-Istog lagja Bardhecaj dhe Arifaj", kodi (53457) në shumë prej: 1,956.00 €.
 2. "Ndërtimi i rrugëve në Carallukë lagja Xhemaj dhe Sylaj", kodi (53478) në shumë prej: 13,796.50 €.
 3. "Ndërtimi rrugës Niman Sadria në Shushicë të Ulët", kodi (53436) në shumën prej: 1,488.00 €.
 4. "Ndërtimi i rrugëve në Trubuhoc lagja Osmanaj, Bajraktari dhe Çetaj", kodi (53421), në shumë prej: 16,432.00 €.
 5. "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Nekaj në Shushicë të Ulët", kodi (53447) në shumën prej: 1,562.00 €.
 6. "Ndërtimi i rrugës në lagjen Hoxhaj në Prekallë", kodi (53418), në shumën prej: 5,220.00 €.
 7. "Ndërtimi i rrugëve "Tahir Bajrami dhe Rexhë Kastrati" në Bajicë", kodi (53469) në shumën prej: 9,076.00 €.
 8. "Ndërtimi i rrugëve lokale në Kaliqan : Ukaj Metaj" lodi (50385) në shumën prej: 1,665.00 €.
 9. "Ndërtimi i rrugës në lagjen Cakutaj në Kaliqan rruga Tre Dëshmoret" kodi (53461) në shumën prej: 11,850.00 €.
 10. "Ndërtimi i rrugës në lagjen Imeraj në Padalishtë" kodi (50920) në shumën prej: 6,348.40 €.
 11. "Ndërtimi i rrugëve në Suriganë lagja Murataj, Mahmutaj, Zeqiraj, Veselaj dhe Seferaj" kodi (53468) në shumën prej: 2,182.00 €.
 12. "Ndërtimi i rrugës Idriz Nekaj në Shushicë" kodi (54999) në shumën prej: 16,231.60 €.
 13. "Ndërtimi i rrugëve në Prigodë lagja Gashi, Ramqaj dhe Dreshaj" kodi (53516) në shumën prej: 18,536.50 €.
6. Në kuadër të programit Arsim dhe Shkencë me kod 920, në nën programin Arsimi i mesëm i lartë, me kod 94680, shuma prej 66,968.11€, të bartet në kategorinë Ekonomike Shpenzime Kapitale, në programin Arsim dhe Shkencë me kod 920, në nën programin Arsimi i mesëm i lartë, me kod 94680 të barten në këto projekte:

1. "Ndërtimi i infrastrukturës së jashtme në shkollën Mithat Frashëri në Gurrakoc" kod (52748) në shumën prej: 16,968.11 €.

2. "Fasadimi i objektit të shkollës Mithat Frashëri në Gurrakoc" kod (I RI) në shumën prej : 50,000.00 €.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministra e Financave, Punës dhe Transferit, Kryetari i Komunës, Drejtori për Buxhet e Financa, Zyrtari kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit të Komunës së Istogut.


Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova
(Signature)